

**AKT I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AE ENERGY” sh.p.k**

Sot me date 20.04.2023 une i nenshkruari:

1. Mirash Sokoli, lindur ne Peraj, Tropoje, Shqiperi me date 20.11.1956, mbajtes i leternjoftimit nr. personal F61120114Q, me zotesi te plote per te vepruar; me ane te ketij dokumenti themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur “AE ENERGY” sh.p.k, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 1
Emertimi**

- 1.1 Themelohet nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e emertuar “AE ENERGY” (ne vijim e quajtur “Shoqeria”)
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar si dhe fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 1.3 Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me statutin.

**Neni 2
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen rruga “Ibrahim Rugova”, Hyrja Nr. 7, Ap. 32, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijojte filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 3
Objekti**

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e meposhtme:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjise elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e eres, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet pergjegjese shteterore (qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.



- Shitja me shumice dhe pakice e energjise elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Energjise Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te energjise jashte vendit.

Pervec sa me siper, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektin e mesiperem. Per arritjen e qellimit te mesiperem, Shoqeria mund te kryeje cdo transakcion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe cdo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise. Duke perfshire por pa u kufizuar ne linjat elektrike te tensionit te larte dhe te mesem, nenstacione elektrike dhe njesi te tjera te lidhjeve elektrike, rrugeve te aksesit etj., si dhe cdo aktivitet aksesori i lidhur me sa me siper, si punime germimi, punime per prishjen dhe punime te tjera te tokes, punime civile, elektrike dhe mekanike te cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkembim, import-eksport te pajisjeve, riparim dhe mirembajtje te materialeve dhe pajisjeve dhe te gjithë aktivitetet e lidhura me keto ceshtje, gjithashtu dhe ne fushen e aktiviteve te tregimit.

Neni 4

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar per nje periudhe kohore te pakufizuar. Asambleja e Ortakeve mund te shkurtojë kohezgjatjen e Shoqerise.

Neni 5

Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 Lek (dhjete mije lek), 1 kuote me vlere 10,000 lek.

Kapitali themeltar ne para eshte nenshkruar nga Ortaku i Vetem i Shoqerise si me poshte:

- Mirash Sokoli, lindur ne Peraj, Tropoje, Shqiperi me date 20.11.1956, mbajtes i leternjoftimit nr. personal F61120114Q, me zotesi te plote per te vepruar, zoterues i 1 kuote me vlere 10,000 Lek qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise;

5.2 Pergjegjesia e ortakeve per detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve shtrihet deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

5.3 I gjithë kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe zoterohet teresisht nga Ortaket e Shoqerise.

Neni 6

Administrimi

6.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori i vetem:

- a) Mund te mos jete ortak;

b) Do te ushtroje detyren per nje periudhe qe do te percaktohet kohe pas kohe nga Asambleja e Ortakeve ne aktin e emerimit, e cila ne asnje rast nuk mund te jete me e gjate se 5 vite;
Perjashtimisht, detyren e pare te Administratorit te Vetem do ta ushtroje z. Aldo Qordja, lindur ne Tirane, Shqiperi me date 04.11.1991, mbajtes i leternjoftimit nr.personal J11104037U. Administratori i Shoqerise ushtron kompetencat e tij sic parashikohet nga dispozitat e ligjit.

Neni 7
Viti Ushtrimor

Viti ushtrimor i shoqerise fillon me date Janar dhe mbyllet me date 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me date 31 Dhjetor 2023.

Neni 8
Prishja dhe Likuidimi

Ne rast prishje dhe likuidimi te Shoqerise, per cfaredo arsye dhe ne cdo moment, Asambleja e Ortakeve do te emeruje lukidatorin ose likuidatoren ne perputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 9
Ligi i Zbatueshem

9.1 Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do t'i behet shprehimisht reference Statutit te Shoqerise dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare, vecanerisht ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
9.2 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Akti Themelimi si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe ortakeve, apo midis vete ortakeve, qe nuk mund te zgjidhet ne mirekuptim midis tyre, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 10
Te ndryshme

Ky Akt Themelimi i Shoqerise eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, secila me vlere te njejte, dhe nenshkruar rregullisht nga ortaket.

Tirane, 20 Prill 2023

ORTAKU I VETEM THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE
"AE ENERGY" sh.p.k

MIRASH SOKOLI

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Mirash Sokoli', written over a faint rectangular stamp or box.